



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVO  
REPUBLIC OF KOSOVA

QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E ARSIMIT E  
SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË

MINISTARSTVO OBRAZOVANJA  
NAUKE I TEHNOLOGIJE

MINISTRY OF EDUCATION  
SCIENCE & TECHNOLOGY


# *TESTI I MATURËS*

## **ARSIMI PROFESIONAL II (ELEKTROTEKNIKË, KOMUNIKACION, MAKINERI, NDËRTIMTARI, GJEODEZI, GRAFIKË, TEKSTIL)**

Emri dhe mbiemri i nxënësit .....

Shkolla.....

**MATEMATIKË**  
**FIZIKË**  
**INFORMATIKË**  
**EKONOMI ME**  
**NDËRMARRËSI**




## Udhëzime:

**Koha:** Keni 180 minuta që t'ju përgjigjeni 80 kërkesave (pyetjeve). Koha numërohet prej momentit kur do të filloni t'i zgjidhni kërkesat.

## Si të veproni?

1. Plotësojini me kujdes, sipas udhëzimeve, të gjitha kodet (në rreth), për: komunën, shkollën, paralelen, numrin e ditarit. Nëse këto të dhëna nuk i plotësoni saktë, nuk do të mund të nxirret rezultati i testit tuaj.
2. Para se të filloni t'ju përgjigjeni pyetjeve, qetësohuni plotësisht, sepse kjo do t'ju ndihmojë.
3. Lexojini me kujdes kërkesat dhe pastaj shënojeni vetëm përgjigjen e saktë, nga 4 mundësitë e dhëna, për të cilën besoni se është e saktë.
4. Fleta e përgjigjeve duhet të plotësohet vetëm me laps të thjeshtë - laps HB.
5. Mbusheni kodin (në rreth) e përgjigjes së saktë me laps të thjeshtë, pa e shkarravitur jashtë. Shih shembullin e mëposhtëm.



6. Kini kujdes që përgjigjen e saktë të një pyetjeje të mos ia vendosni pyetjes tjetër të radhës.
7. Në Fletën e përgjigjeve nuk bën të shkruani tjetër gjë, përveç përgjigjeve për të cilat jeni të bindur se janë të sakta.
8. Përgjigjet e sakta plotësohen njëkohësisht – në Test dhe në Fletën e përgjigjeve.
9. Çdo lloj llogaritjeje mund ta bëni në faqen e fundit të testit, ndërsa në fletën e përgjigjeve nuk bën të shkruani tjetër gjë, përveç përgjigjeve, për të cilat jeni të bindur se janë të sakta.
10. Mos humbni kohë me pyetjet që nuk i dini, sepse koha mund të mos ju mjaftojë për pyetjet e tjera.
11. Përdoreni deri në fund kohën e testimit, në mënyrë që t'ju përgjigjeni të gjitha pyetjeve.

# MATEMATIKË

1. Sa është vlera e shprehjes  $A = \log_2 50 - \log_2 25$  ?

- A. 0
- B. 1
- C. 5
- D. 10

2. Është dhënë ekuacioni trigonometrik:  $2 \sin x - (\cos x)^0 = 0$ ,  $(0 < x < \frac{\pi}{2})$ .

Cila është zgjidhja e tij?

- A.  $x = 0$
- B.  $x = \frac{\pi}{2}$
- C.  $x = \frac{\pi}{3}$
- D.  $x = \frac{\pi}{6}$

3. Sa është vlera  $x$  nga zgjidhja determinantes  $\begin{vmatrix} 5 & x \\ -3 & 6 \end{vmatrix} = 36$  ?

- A.  $x = 6$
- B.  $x = 5$
- C.  $x = 2$
- D.  $x = 1$

4. Janë dhënë vektorët:  $\vec{a} = 2\vec{i} + 3\vec{j} - \vec{k}$  dhe  $\vec{b} = \vec{i} - 3\vec{j} + 2\vec{k}$ . Sa është vlera  $\vec{m} = 2\vec{a} - 3\vec{b}$  ?

- A.  $\vec{i} + 15\vec{j} - 8\vec{k}$
- B.  $\vec{i} - 5\vec{j} + 6\vec{k}$
- C.  $6\vec{i} + 3\vec{j} - 2\vec{k}$
- D.  $2\vec{i} - 5\vec{j} + 12\vec{k}$

5. Nëse janë dhënë rrethi:  $x^2 + y^2 = 8$  dhe drejtëza:  $y = x$ . Cilat janë pikëprerjet e tyre:

- A. (0,0) dhe (0,1)
- B. (1,1) dhe (-1,-1)
- C. (4,4) dhe (-4,-4)
- D. (2,2) dhe (-2,-2)

6. Sa është vlera e limitit:  $\lim_{x \rightarrow 3} \frac{x^2 - 9}{x - 3}$

- A. - 6
- B. 6
- C. - 3
- D. 3

7. Cilën veti e plotëson funksioni eksponencial  $y = 2^x$  ?

- A. E pret boshtin oy në pikën 1.
- B. Është gjithkund zvogëlues.
- C. Është gjithkund negativ.
- D. Është i përkufizuar vetëm për  $x \geq 0$

8. Cili është intervali i përkufizimit të funksionit  $y = \sqrt{1 - x^2}$  ?

- A.  $[-1, 1)$
- B.  $(-1, 1]$
- C.  $[-1, 1]$
- D.  $(-1, 1)$

9. Një nxënës në Testin e Maturës Shtetërore ka arritur këtë numër të përgjigjeve të sakta: Gjuhë amtare (37 nga 50), Gjuhë angleze (33 nga 40), Matematikë (20 nga 30). Sa % të pikëve i ka arritur ai nxënës në Testin e Maturës Shtetërore?


- A. 55%
- B. 75%
- C. 65%
- D. 85%

10. Cila është zgjidhja e ekuacionit  $2^{2015x-1} = \frac{1}{2}$  ?

- A.  $x = 0$
- B.  $x = -2$
- C.  $x = -1$
- D.  $x = 1$

11. Trekëndëshi  $A'B'C'$  është fituarë e transformuar nga trekëndëshi  $ABC$ , me anë të një transformimi izometrik të vetëm. Cili është ky transformim?

- A. Translacion
- B. Rotacion
- C. Simetri boshtore
- D. Simetri qendrore



12. Sa është shuma e këndeve  $\alpha = \frac{\pi}{3}$  dhe  $\beta = 210^\circ$  ?

- A.  $\pi$
- B.  $\frac{3\pi}{2}$
- C.  $\frac{2\pi}{3}$
- D.  $2\pi$

13. Diferenca e dy numrave është 3 herë më e vogël se shuma e tyre cilët janë ata numra:

- A. 20 dhe 15
- B. 35 dhe 17
- C. 54 dhe 29
- D. 32 dhe 16

14. Në një zyrë pune, temperatura kontrollohet me një termostat elektronik. Temperatura ndryshon sipas funksionit  $y = 19 + 6\sin\left(\frac{\pi}{12}(x-11)\right)$ , ku  $y$  është temperatura në  $^\circ\text{C}$  dhe  $x$  është numri i orëve pas mesnatës. Sa është temperatura në zyre, në ora 9:00 të mëngjesit?

- A.  $20^\circ\text{C}$
- B.  $18^\circ\text{C}$
- C.  $16^\circ\text{C}$
- D.  $14^\circ\text{C}$

15. Cili është ekuacioni i rrethit me qendër në pikën  $Q(3,2)$  dhe rreze  $r=5$ ?

- A.  $(x+3)^2 + (y-2)^2 = 5$
- B.  $(x-3)^2 + (y-2)^2 = 25$
- C.  $(x-3)^2 + (y-2)^2 = 5$
- D.  $(x+3)^2 + (y-2)^2 = 25$

16. Një punëtor në ditën e parë mblodhi 40 kg dredhëza, ndërsa për çdo ditë tjetër ai mblodhi nga 5 kg më shumë se në ditën paraprake. Për çdo kilogram dredhëzash të mbledhura paguhej me nga 0.2 €. Sa euro i fitoi punëtori për 10 ditë pune?

- A. 137 €
- B. 135 €
- C. 125 €
- D. 127 €

17. Perimetri i bazës së një koni të drejtë është  $10\pi$  cm, ndërsa lartësia e tij është 9cm. Sa është vëllimi i atj konit?


- A.  $V = 75\pi \text{ cm}^3$
- B.  $V = 70\pi \text{ cm}^3$
- C.  $V = 80\pi \text{ cm}^3$
- D.  $V = 85\pi \text{ cm}^3$

18. Nëse  $3 \cdot (2a - 1) = 0$ , atëherë sa është  $4 \cdot (3a - 2)$  ?

- A. 1
- B. 2
- C. -1
- D. -2


19. Cili segment paraqet  $\sin \alpha$ , sipas të dhënave në figurë?

- A. [AB]
- B. [OA]
- C. [OB]
- D. [BM]



20. Cili është ekuacioni i drejtëzës  $d$ , e dhënë në figurë?

- A.  $d: 4x + 5y + 20 = 0$
- B.  $d: 5x - 4y + 20 = 0$
- C.  $d: 5x + 4y - 20 = 0$
- D.  $d: 4x - 4y - 20 = 0$




# FIZIKË

21. Si quhet rrymimi i fluidit në rast se vijat e rrymimit janë paralele mes veti?

- A. Laminar
- B. Jostacionar
- C. Stacionar
- D. Turbulent

22. Një makinë lëvizë nëpër trajektore me rreze ( $r$ ) si në figurë. Në cilin nga drejtimet e horizontit është vektori i shpejtësisë lineare ( $v$ )?

- A. Jug
- B. Veri
- C. Lindje
- D. Perëndim




23. Për cilën nga madhësitë fizike  $N$  (Njutni) është njësi matëse?

- A. Energjinë
- B. Shtypjen
- C. Peshën
- D. Masën

24. Një tel i drejtë lëvizë duke rritur shpejtësinë normal me vijat e fushës magnetike si në figurë. Çka ndodh me tensionin në skajet e përçuesit?

- A. Nuk ndryshon
- B. Bëhet zero
- C. Zvogëlohet
- D. Rritet



25. Sa do të jetë energjia potenciale e ngarkesës me masë  $m = 5\text{kg}$  nëse ajo ngritet në lartësinë  $h = 2\text{m}$  dhe nëse  $g = 10 \frac{\text{m}}{\text{s}^2}$ ?

- A.  $1000\text{J}$
- B.  $100\text{J}$
- C.  $10\text{J}$
- D.  $1\text{J}$

26. Nëse te thjerra me zmadhim  $Z = 2$  fitohet shëmbëllimi në distancën  $b = 20\text{cm}$ , atëherë në çfarë distance është i vendosur trupi  $a$ ?

- A.  $a = 10\text{cm}$
- B.  $a = 20\text{cm}$
- C.  $a = 40\text{cm}$
- D.  $a = 5\text{cm}$

27. Në dy enë me vëllime të njëjta dhe temperaturë konstante janë të vendosura masa të njëjta të gazrave të ndryshëm. Nëse në enën e parë gjendet gasi me densitet  $\rho_1$ , kurse në enën e dytë gasi me densitet  $\rho_2 = 2\rho_1$ , atëherë si do të jenë raportet e shtypjeve përkatëse  $\frac{P_1}{P_2}$  ?


- A.  $\frac{P_1}{P_2} = \sqrt{2}$
- B.  $\frac{P_1}{P_2} = \frac{1}{2}$
- C.  $\frac{P_1}{P_2} = 2$
- D.  $\frac{P_1}{P_2} = \frac{1}{\sqrt{2}}$

28. Si quhet ligji: “Trupi i zhytur në lëng humb nga pesha e vet për aq sa është pesha e lëngut vendin e të cilit e zë trupi”?

- A. Paskalit
- B. Toriqelit
- C. Arkimedit
- D. Bernulit

29. Varësia e ndryshimit të pozitës sipas kohës për një trup është si në figurë. Sa është shpejtësia e lëvizjes për këtë rast ?

- A.  $v = 2 \frac{m}{s}$
- B.  $v = 0,5 \frac{m}{s}$
- C.  $v = 5 \frac{m}{s}$
- D.  $v = 10 \frac{m}{s}$



30. Nëse dëshirojmë që rezistencën e një teli metalik t’a dyfishojmë, sa duhet t’a ndryshojmë gjatësinë e tij?

- A. Të zvogëlojmë për dy herë
- B. Të zmadhojmë për dy herë
- C. Të zvogëlojmë për katër herë
- D. Të zmadhojmë për katër herë



## INFORMATIKË

- 31.** Nëse një prezantim duhet të ketë pamje të njëjtë, duhet të përdoret opsioni:
- A. Slide show
  - B. Outline view
  - C. Layout option
  - D. Design template
- 32.** Cili prej objekteve vijuese të një baze të dhënash i ruan shënimet:
- A. Table
  - B. Forms
  - C. Queries
  - D. Reports
- 33.** Një pjesë e një baze të dhënave e cila ruan shënimet për një entitet të vetëm (një punëtor, një pagë, etj.), quhet:
- A. File
  - B. Record
  - C. Field
  - D. Query
- 34.** Sa është shuma e numrave binar:  $11001+10011$ ?
- A. 101100
  - B. 100011
  - C. 111110
  - D. 111111
- 35.** Cila prej shprehjeve të listuara më poshtë ka të bëjë me mësimin nëpërmjet kompjuterit, përkatësisht mësimin në distancë:
- A. E-word
  - B. M-commerce
  - C. E-learning
  - D. M- library
- 36.** Nëse një sinjal elektrik  $A=10100$  kyçet në portin Not Gate, në dalje do të fitohet:
- A. 10001
  - B. 01011
  - C. 10101
  - D. 00101
- 37.** Sa është numri i gjendjeve që mund të fitohen me një kod 7 bitësh:
- A. 128
  - B. 256
  - C. 512
  - D. 1024

**38.** Një shifër për identifikim (password) preferohet të ketë:

- A. Shkronja të mëdha dhe numra
- B. Shkronja të vogla dhe numra
- C. Shkronja të vogla, numra dhe shenja të interpunkcionit
- D. Shkronja të mëdha, shkronja të vogla, numra dhe shenja të interpunkcionit.

**39.** Cila prej memorieve vijuese duhet të rifreskohet shumë herë në një sekond:


- A. Ram-i dinamik
- B. RAM-i statik
- C. EPROM
- D. ROM

**40.** Për të vendosur një regjister ose numërues në pozitën zero, duhet të përdoret opsioni :

- A. Remote
- B. Reset
- C. Return
- D. Release

**41.** Sa do të jetë vlera në celulën A3, nëse skaji i djathtë i poshtëm i qelulave të zgjedhura tërhiqet poshtë:


- A. 3
- B. 2
- C. 1
- D. 0



	A	B
1	1	1
2		1
3		
4		

**42.** Adresa e një qelule do të jetë kombinim i një shkronje që përcakton kolonën dhe numrit që përcakton rreshtin. Adresa e qelulës së zgjedhur mund të gjendet në opsionin e quajtur:

- A. Ribbon
- B. Name Box
- C. Formula Bar
- D. Formula Box



**43.** Cili prej opsioneve vijuese duhet përdorur, nëse dëshironi që Logo e juaja të vendoset njëkohësisht dhe në pozicion të njejtë, në secilin sllajd :

- A. Slide master
- B. Handout master
- C. Notes master
- D. Vendoset me cilindo prej opsioneve të mësipërme

- 44.** Si quhet memoria e përkohshme e të dhënave, e cila ndodhet ndërmjet njësisë qendrore procesorike dhe njësisë periferike dhe e cila ruan të dhënat që presin radhën për ekzekutim, si pasojë e mospërputhjes së shpejtësisë së komunikimit ndërmjet njësive përkatëse:
- A. Main storage
  - B. Temporary storage
  - C. Buffer
  - D. Backing storage
- 45.** Instruksionet dhe adresat e memories paraqiten me:
- A. Kode të karaktereve
  - B. Bite të paritetit
  - C. Kode ternare
  - D. Kode binare
- 46.** Opsioni System Restore do të bëjë të mundur:
- A. Rikthimin e të dhënave që janë fshirë rastësisht
  - B. Kthimin e gjendjes së sistemit në një moment para dëmtimit të tij
  - C. Instalimin e sërishëm të sistemit operativ
  - D. Instalimin e sërishëm të programeve aplikative
- 47.** Në adresën <http://www.search.ieice.org>, pjesa e cila specifikon protokolin për komunikim është:
- A. www.
  - B. search.
  - C. http
  - D. ieice.org
- 48.** Për të dërguar një kopje të postës elektronike te marrësi i cili nuk duhet të shihet nga marrësit tjerë të asaj porosie, duhet shfrytëzuar opsionin :
- A. Bcc
  - B. Cc
  - C. To
  - D. Subject
- 49.** Bartja e të dhënave prej shfrytëzuesit në drejtim të serverit, quhet:
- A. Download
  - B. Serial stream
  - C. Upload
  - D. Paralel stream
- 50.** Cila prej pajisjeve vijuese përdoret për bartjen e të dhënave ndërmjet rrjetit lokal dhe Internetit:
- A. Hub
  - B. Router
  - C. Switch
  - D. Bus

**51.** Një adresë URL në Internet paraqet:

- A. Web faqe të zakonshme
- B. Adresë unike të një kompjuteri
- C. Adresë unike të një shfrytëzuesi të Internetit
- D. Web adresë të një resursi të caktuar në Internet

**52.** Cili prej opsioneve të paraqitur paraqet një dyshe të programeve për shfletimin e të dhënave në Web faqe:

- A. Mozilla Firefox, Opera
- B. Opera, Windows Explore
- C. Internet explorer, Ms Word
- D. Windows Explorer, Internet Explorer

**53.** Shkurtesa DNS është e lidhur me një IP adresë dhe mundëson:

- A. Shikimin e Web faqeve me IP adresa
- B. Përkthimin e IP adresës numerike të kompjuterit në adresë me shkronja
- C. Përcakton madhësinë e web faqeve
- D. Mundëson lidhjen e disa IP adresave me Web faqet përkatëse

**54.** Interneti punon në bazë të:

- A. Komutimit të paketeve dhe komutimit të qarqeve
- B. Komutimit të qarqeve ose komutimit të paketeve
- C. Komutimit të qarqeve
- D. Komutimit të paketeve

**55.** Cili është kombinimi i tasteve që përdoret për vendosjen e datës aktuale në qelulë:

- A. Ctrl + ”
- B. Ctrl + ;
- C. Ctrl + >
- D. Ctrl + <


## EKONOMI ME NDËRMARRËSI

- 56.** Përdorimi i mjeteve tarifore dhe jotarifore për kufizimin, përkatësisht stimulimin e importit dhe eksportit bëhet përmes:
- A. politikës tregtare
  - B. politikës fiskale
  - C. politikës monetare
  - D. politikës së të ardhurave
- 57.** Cili lloj i papunësisë shkaktohet nga rënia e aktiviteteve të biznesit?
- A. Papunësia strukturore
  - B. Papunësia friksionale
  - C. Papunësia ciklike
  - D. Papunësia e fshehtë
- 58.** Cila nga përgjigjet e mëposhtme konsiderohet veti e parasë?
- A. Qëndrueshmëria e parasë
  - B. Paraja si masë e vlerës
  - C. Paraja si mjet kursimi
  - D. Paraja si mjet këmbimi
- 59.** Bilanci i gjendjes paraqet gjendjen pasurore të ndërmarrjes. Çfarë evidentohet në anën e majtë të bilancit përkatësisht në aktivin e bilancit?
- A. Huat afatgjata
  - B. Borxhet ndaj furnitorëve
  - C. Kapitali i sjellur nga aksionarët
  - D. Mjetet e përhershme
- 60.** Denimet e arkëtuara në kontabilitet evidentohen si:
- A. të dala të jashtëzakonshme
  - B. të hyra të jashtëzakonshme
  - C. të dala të rregullta
  - D. të hyra të rregullta
- 61.** Çfarë roli kanë menaxherët e nivelit të lartë të menaxhmentit?
- A. Mbikëqyrës
  - B. Integruer
  - C. Ekzekutiv
  - D. Organizativ
- 62.** Cili funksion i menaxhimit përfshin procesin e rregullimit të aktiviteteve ashtu që performanca reale të jetë në pajtim me qëllimet e pritura të organizatës?
- A. Kontrolli
  - B. Planifikimi
  - C. Udhëheqja
  - D. Organizimi
- 63.** Cila teknikë e përgatitjes së menaxherëve ka të bëjë me krijimin e përvojës në punë përmes kalimit në pozita të ndryshme menaxheriale?
- A. Teknika me mentor
  - B. Teknika e rotacionit
  - C. Kurset dhe programet
  - D. Seminaret e specializuara

- 64.** Çfarë përfaqësojnë puna, toka dhe kapitali?
- Faktorë të prodhimit
  - Të mira normale
  - Çmime të faktorëve të prodhimit
  - Produkte dhe shërbime
- 65.** Çka pasqyron problem themelor të çdo sistemi ekonomik?
- Shpërndarja e burimeve të kufizuara ndaj nevojave njerëzore të kufizuara
  - Shpërndarja e burimeve të kufizuara ndaj nevojave njerëzore të pakufizuara
  - Shpërndarja e burimeve të pakufizuara ndaj nevojave njerëzore të kufizuara
  - Shpërndarja e burimeve të pakufizuara ndaj nevojave njerëzore të pakufizuara
- 66.** Çfarë është kosto oportune e blerjes së një kompjuteri?
- Çmimi i paguar për kompjuter
  - Kosto e mirëmbajtjes së kompjuterit
  - Vlera e të mirave të tjera që do të mund të blihen me paratë e shpenzuara për kompjuter
  - Diferenca mes çmimit të kompjuterit të blerë dhe të një kompjuteri të përdorur
- 67.** Ligji i kërkesës ilustron përmes lakores së kërkesës e cila është:
- vertikale
  - horizontale
  - me pjerrësi pozitive
  - me pjerrësi negative
- 68.** Çfarë ndikon në ofertën e firmës për produkte dhe shërbime?
- Çmimet e faktorëve të prodhimit
  - Të ardhurat e konsumatorëve
  - Pritjet e konsumatorëve
  - Numri i blerësve
- 69.** Cilat janë konceptet makroekonomike?
- Kërkesa individuale dhe oferta individuale
  - Inflacioni, punësimi dhe papunësia
  - Puna, toka dhe kapitali
  - Paga, renta dhe interesi
- 70.** Cila nga tiparet e mëposhtme e karakterizon ekspansionin ekonomik?
- Norma e papunësisë rritet
  - Norma e punësimit zvogëlohet
  - Norma e papunësisë zvogëlohet
  - Norma e punësimit nuk ndryshon
- 71.** Cila nga përgjigjet e mëposhtme shpjegon suficitin tregtar?
- Importi është më i madh se eksporti
  - Të hyrat publike tejkalojnë të dalat publike
  - Të dalat publike tejkalojnë të hyrat publike
  - Eksporti është më i madh se importi
- 72.** Çfarë paraqet një rritje e vazhdueshme në nivelin e përgjithshëm të çmimeve?
- ekspansionin
  - deflacionin
  - inflacionin
  - rritjen ekonomike

**73.** Nëse për çmimin 3 euro, firma A ofron 100 njësi produkt në treg dhe firma B ofron 150 njësi, sa do të jetë oferta e tregut?

- A. 250 njësi
- B. 300 njësi
- C. 450 njësi
- D. 750 njësi



**74.** Duke iu referuar figurës, rretho sasinë dhe çmimin ekuilibër:

- A. çmimi 8 euro, sasia 80
- B. çmimi 10 euro, sasia 100
- C. çmimi 8 euro, sasia 140
- D. çmimi 14 euro, sasia 140

**75.** Çka paraqet shkalla e reagimit të konsumatorit ndaj ndryshimit të çmimit të produktit?

- A. Ligjin e ofertës
- B. Ligjin e kërkesës
- C. Elasticitetin e ofertës
- D. Elasticitetin e kërkesës

**76.** Nëse çmimi i një produkti rritet nga 1 € në 2€, kurse konsumatori vazhdon të blej 5 njësi si më parë, fuqia blerëse e konsumatorit do të:

- A. rritet për 5€
- B. rritet për 2€
- C. zvogëlohet për 5€
- D. zvogëlohet për 2€

**77.** Ndërmarrja tregtare që merret me shitjen me pakicë ka kosto totale 15.000€, ndërsa kostot fikse janë 4.500€. Sa janë kostot variabile të këtij biznesi?

- A. 10.000€
- B. 10.500€
- C. 19.500€
- D. 20.000€

**78.** Cila nga kostot e mëposhtme konsiderohet kosto fikse?

- A. Lënda e parë
- B. Materiali ndihmës
- C. Lënda djegëse
- D. Qiraja e objektit

**79.** Qëndrueshmëria dhe stabiliteti i kompanisë konsiderohet përparësi e :

- A. korporatave
- B. firmave individuale
- C. ortakërive me përgjegjësi të kufizuar
- D. ortakërive me përgjegjësi të pakufizuar

**80.** Në cilën formë të tregut firmave hyn më lehtë në degë?

- A. Në oligopol
- B. Në monopol
- C. Në konkurrencë monopolistike
- D. Në konkurrencë të plotë